


Fejton: “Shpërbërja e Jugosllavisë” (11)

Frika dhe fyerja

Nuk është rastësi se propagandat e suksesshme, si në Jugosllavi ashtu edhe në vende të tjera, shpesh kanë luajtur me letrën e frikës dhe fyerjeve që ekzistonin përpara

Padrejtësitë e ndryshme dhe padrejtësitë e supozuara që u bënë (apo që mendohej se u bënë) gjatë viteve 1918-1991 nuk “shkaktuan” shkrirjen e Jugosllavisë. Ato vetëm kontribuan në sigurimin e kufijve ndërmjet grupeve, mosbesimin dhe fyerjen ndërmjet tyre, duke dhënë tema, baza e të cilave i mjaftonte një politikani ambicioz që të mobilizojë grupin e tij kundër të tjerëve. Diferencat në perceptimin si të historisë së largët ashtu edhe asaj të afërt ndihmojnë për të llogaritur edhe perceptimin që i bënte popullata temave të veçanta propaganduese, në të vërtetë temave të ndryshme propaganduese. Me gjasë duhet theksuar se vetëm serbët kishin nocionin e quajtur kombëtar, të përfshirë në frazën “Serbia hyjnore”, përderisa popujt e tjerë të Jugosllavisë e shihnin veten si viktima, përfshirë këtu edhe sllovenët, disa prej të cilëve ende vazhdojnë të bluanë në mendje përvojat historike me gjermanizimin, italianizimin, pa i përmendur eksperiencat e fundit me

“jugosllavizimin”. Psikologët i dinë shumë mirë ndryshimet në sjellje të të vetëquajturve viktima dhe atyre që nuk e shohin veten si viktima. Sipas llogaritjeve të mëhershme, duhet të jetë e qartë se serbët mund të japin arsyet e tyre pse nuk mund t'i duronin kroatët, boshnjakët dhe shqiptarët e Kosovës (e madje edhe pse u frikoheshin shqiptarëve të Kosovës), kroatët mund të japin arsyet e tyre pse u frikoheshin dhe nuk mund t'i duronin serbët, boshnjakët mund të japin arsyet pse u frikoheshin dhe pse nuk mund t'i duronin serbët dhe pse e kanë ushqyer një zemërim të vazhdueshëm për kufijtë e banovinës jetëshkurtër. Edhe shqiptarët e Kosovës kishin arsye të mos i duronin dhe t'u frikoheshin serbëve. Sipas Roger Petersenit, shpërbërja e Jugosllavisë është e mundur të ketë shkaktuar reaksione emocionale midis serbëve dhe kroatëve të Bosnjës. Ai supozon se “edhe kroatët edhe serbët e kanë menduar si jonatyrale edhe katasrofale mundësinë e ardhjes në pozitë superiore të



myslimanëve në hierarkinë etnike. Me fjalë të tjera, fyerja dhe frika, i kanë motivuar kriminelët”. Kjo ndoshta ka qenë temë e dytë për kroatët dhe serbët e Bosnjës, por tema parësore, sipas mënyrës si u bë shkrirja e Jugosllavisë në Bosnjë ishte koncepti i shtetit. Milosheviqi përpiqej të themelonte “Serbinë e madhe”, Tuxhmani ishte i ekskluzuar me prospektin e rivendosjes së kufijve në banovinë, ndërsa Izetbegoviqi dëshironte ta ruante republikën e Bosnjës brenda kufijve ekzistues. Me këto tri koncepte jokompatible ndërmjet rivalëve, potenciali për konflikt ishte qartazi prezent - me ose pa postulatet për fyerje për myslimanët që po ngriheshin në

shkallë burokratike. Peterseni vë theks të veçantë në vëzhgimin e tij se “se nuk ka arsye të supozohet se elita gjithmonë e detyron dhe manipulon me masën se sa që ndodhë e kundërta. Shumë herë është e pamundur të përcaktohet se kush kë po e udhëheq”. Por është e mundur që liderët nuk janë vetëm duke shpikur nocionet aty për aty, ose të mbahen vetëm në spangot e marionetave nga publiku i vetëdijesuar. Realiteti, siç do të thoshte Peterseni, mund të jetë simbiotik, me liderë që luajnë me audiencën që i pranon, duke shfrytëzuar fyerjen e së kaluarës si një lloj “mbushjeje” për arritjen e tyre në pushtet. Nuk është rastësi se propagandat e suksesshme, si në Jugosllavi ashtu

“Shpërbërja e Jugosllavisë” është raport i përpiluar nga projekti “Iniciativa e intelektualëve”, rreth të cilit janë mbledhur historianë të shumtë nga Ballkani dhe mbarë bota për të hulumtuar gjenezën e konfliktit në ish-Jugosllavi. Ky projekt ka punuar në disa grupe të ndara, të cilat kanë trajtuar aspekte të ndryshme dhe kanë përpiluar raporte të veçanta. Grupi që ka punuar raportin rreth “Shpërbërjes së Jugosllavisë” është udhëhequr nga Sabrina Ramet dhe Latinka Peroviq. Për shkak të hapësirës, “Koha Ditore” e boton si fejton një variant të shkurtuar të raportit.

edhe në vende të tjera, shpesh kanë luajtur me letrën e frikës dhe fyerjeve që ekzistonin përpara.

(Në numrin e nesërm: Frika nga “libanizimi” në vitet e 80-ta, thellimi i krizës ekonomike dhe morale, borxhet e Jugosllavisë, rreziku në rritje i shpërbërjes)

Fejton: “Sekretet e spiunazhit botëror” (11)

Vendi më i ftohtë i luftës së ftohtë

Berlini i ndarë ishte fushëlojë për spiunë

Ishte viti i ri 1962 kur ndërgjegjja e Margaretes doli fitimtare. Një besimtare e devotshme katolike, gruaja e re që punonte

përkthyesë në qendrën komanduese të NATO-s kishte një lidhje dashurie me njeriun për të cilin besonte se ishte zyrtar

danez i zbulimit. Për më tepër, ajo e furnizonte atë me informata të klasifikuara që i merrte në vendin e punës. Kjo nuk është tradhti, e siguronte i dashuri i saj “Kai Peteresen”. Ajo thjesht po i ndihmonte një vendi të vogël që normalisht është i përjashtuar nga njohuritë që kanë vendet e mëdha në NATO. E megjithatë, Maragarete ndjente faj se ajo dëshironte të rrëfehej te prifti. Njëkohësisht, shefat e shërbimit sekret të Gjermanisë Lindore, Stasi, mendoheshin sesi ta ruajnë mbulesën e Peteresenit, që për ta ishte Roland G., një nga spiunët më të mirë të Gjermanisë komuniste. “Kishim nevojë të gjejmë një prift për këtë grua”, kujtonte më vonë Markus Wolf, shefi i shtabit të Stasit në Berlin në vitet 1952-1986. Por, në Berlin, kishte pak gjasa që Stasi të bëjë diç, kështu që disa javë më vonë, në një kishë të vogël në Danimarkë, Margarete është liruar nga ndjenja e fajit. “Prifti” - një agjent gjermanolindor, i tha asaj që të vazhdojë spiunimin me bekimin e Zotit. Në kulmin e luftës së ftohtë, Berlini ishte vendi më i ftohtë në Tokë. I sajuar nga fuqitë kundërshtare menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore, ky qytet u bë kryeqytet i spiunazhit menjëherë kur SHBA-ja dhe sov-

jetikët u armiqësuan. Nëpër rrugët e Berlinit, asokohe, thuhet të kenë ecur 8,000 spiunë. Spiunimi në Berlin e arriti kulmin në vitet '50, një dekadë para se të ngihej Muri i Berlinit. Baza legjendare e CIA-s për operacione në Berlin asokohe i trafikonte agentët në pjesën lindore të qytetit me një lehtësi relative, ndërsa KGB-ja dhe Stasi përdornin si mbulesë mijëra refugjatë që kalonin në pjesën perëndimore të qytetit për të infiltruar spiunët e vet. Në ditët para se satelitët të mund të xhironin mbi territorin e armikut, spiunët në Berlin përdornin të gjitha mjetet për të arritur qëllimin që ishte më i vlefshmi: informatat nga agjentët në terren. Si në filma, kishte ndjekje me vetura dhe spiunë të infiltruar në bordele. Dhe këtë lojë thuhet se askush nuk e luante më mirë se Markus Wolf. Shefi i agjenturës gjermanolindore që inspiroi disa romane spiunazhi thuhet të ketë qenë më i suksesshmi i vendit të tij dhe problemi më i madh për vetë CIA-n. “Si amerikan, më duhet të them se ai ka bërë gjëra që e kanë dëmtuar shumë Amerikën”, thotë eksperti i spiunazhit, H. Keith Melton. “Por si historian, duhet ta admironi për aftësitë që



Markus Wolf, shef për Berlin i shërbimit sekret të Gjermanisë Lindore në vitet 1952-1986, një kohë të gjatë ka qenë mister i plotë për CIA-n, të cilët nuk ia dinin as emrin as fytyrën, prandaj e quanin “Njeriu pa fytyrë”

ka treguar në punën e tij”. I njohur si “Njeriu pa fytyrë”, Wolf ishte një mister aq i madh për Perëndimin dhe CIA-n sa që ata nuk ia dinin as emrin dhe nuk kishin asnjë foto të tij derisa një agjent gjerman nuk iku në Berlinin Perëndimor, më 1979.

(Nesër: Çfarë punë bënin “Spiunët Romeo”? Cili ishte operacioni më i guximshëm i CIA-s në Berlin? Cila ishte dilema e KGB-së?)

